



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 17 qershor 2011
Nr. ref.:RK122/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMERI

në

Rastin Nr. KI 30/11

Parashtruesi

Iljaz Shuleta

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit CI.nr.307/2006 të Gjykatës
Komunale në Prishtinë, të datës 12.02.2007**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKES SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almira Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Cukalovic, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Iljaz Shuleta, nga Prishtina, me banim në Prishtinë Rr."Mbreti Bardhyl" 18/a, i cili përfaqësohet me autorizim nga z. Maliq Lushaku.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë CI nr. 307/2006, i datës 12.02.2007.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më 01.03.2011, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit CI.nr.307/2006 të Gjykatës Komunale në Prishtinë, i datës 12.02.2007, me të cilin është refuzuar padia e paditësit z. Iljaz Shuleta për kthimin e tij në vendin e punës në Korporatën Energjetike të Kosovës, ku më parë kishte shkuar në pension të parakohshëm invalidor sipas kërkesës së tij personale.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i datës 15 janar 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 01.03.2011, z. Iliaz Shuleta parashtrroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese me të cilën kontestonte Aktgjykimin CI.nr.307/2006 të Gjykatës Komunale në Prishtinë, të datës 12.02.2007, me të cilin është refuzuar padia e tij për kthimin në vendin e punës në Korporatën Energjetike të Kosovës, ku më parë kishte shkuar në pension të parakohshëm invalidor sipas kërkesës së tij personale.
6. Më 02.03.2011, Kryetari e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues) dhe Enver Hasani e Gjyljeta Mushkolaj, anëtarë.
7. Gjykata Kushtetuese nuk mori asnjë koment nga palët e përfshira në çështjen që ka të bëjë me kërkesën.
8. Më 19.05.2001, pas raportimit të Gjyqtarit raportues Kadri Kryeziu, Kolegji shqyrtues në përbërje: Robert Carolan (kryesues) dhe Enver Hasani e Gjyljeta Mushkolaj, anëtarë, i rekomandoi përbërjes së plotë të Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Edhe pse parashtruesi i kërkesës nuk e ka bashkëngjitur me kërkesën dokumentacionin e nevojshëm nga kopja e Aktgjykimit Gjykatës Komunale në Prishtinë CI nr .307/2006, i datës 12.02.2007, konstatohet se z. Shuleta ka qenë në marrëdhënie pune në KEK më shumë se 20 vjet pa ndërprerë.
10. Më 23 shtator 2003, gjithnjë sipas të dhënave të nxjerra nga aktgjykimi i sipërpërmendur, ai ka paraqitur kërkesë me shkrim tek punëdhënësi i tij për të dalë në pension invalidor për shkak të gjendjes së përkeqësuar shëndetësore.
11. Më 23 tetor 2003, me Vendimin nr. 171/132, KEK-u ka aprovuar kërkesën e z. Shuleta dhe ia ka njohur të drejtën në pension të përkeqësuar invalidor sipas kategorisë 'B', duke filluar nga 01.01.2003 deri më 01.12.2008.

12. Më 21 prill 2006, z. Shuleta i është drejtuar KEK-ut me kërkesë për kthim në ish-vendin e tij të punës duke e arsyetuar kërkesën me faktin se ai tashmë është shëruar dhe rehabilituar dhe se është i aftë për punë.
13. Duke qenë se kjo kërkesë e tij nuk është miratuar, parashtruesi i kërkesës ka bërë një kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, ku lënda është regjistruar me nr. CI,nr 307/06.
14. Ndërkohë, me shkresa njoftuese parashtruesi i kërkesës, z. Shuleta, ka njoftuar AKM-në dhe KEK-un për fillimin e kësaj procedure.
15. Më 12 shkurt 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë kishte nxjerrë Aktgjykimin CI.nr.307/2006, me të cilin kishte refuzuar kërkesëpadinë e z. Iljaz Shuleta si të pabazuar.
16. Në formularin zyrtar për paraqitjen e kërkesave në Gjykatën Kushtetuese z. Shuleta kishte shkruar se këtë aktgjykim të Gjykatës Komunale ai e kishte pranuar më 10.04.2007.
17. Nga dokumentacioni që ka paraqitur parashtruesi i kërkesës konstatohet se ndaj këtij aktgjykimi nuk është bërë ankesë dhe nuk ka ndonjë aktgjykim tjetër të ndonjë shkalle me të lartë gjyqësore.
18. Përfundimisht, i pakënaqur me aktgjykimin në fjalë të Gjykatës Komunale, z. Iljaz Shuleta nëpërmes përfaqësuesit të tij ligjor (fjalua është e papërfunduar)

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës nuk ka saktësuar se cila e drejtë e garantuar me Kushtetutë pretendon se i është shkelur me vendimin të cilin e sfidon para Gjykatës, edhe pse këtë e ka obligim sipas nenit 48 të Ligjit për Gjykatën kushtetuese.
20. Ai ka pretenduar se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë CI nr .307/2006, i datës 12.02.2007, me të cilin i është refuzuar kërkesëpadija me anë të së cilës ai nga Gjykata kishte kërkuar t`ia njohë të drejtën për kthim në venin e punës në KEK, ka qenë i paligjshëm.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Për të qenë në gjendje për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen në Kushtetutë.
22. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës që përcakton se:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Gjykata, gjithashtu merr parasysh:

Nenin 46 të Ligjit për Gjykatë Kushtetuese të Republikës së Kosovës që i referohet kërkesave individuale dhe në të cilin përcaktohet:

“Gjykata Kushtetuese pranon dhe procedon kërkesën e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore”.

23. Duke analizuar dokumentacionin e paraqitur në lëndë nga ana e parashtruesit të kërkesës, konstatohet se aktgjykimi i fundit i Gjykatës Komunale në Prishtinë është nxjerrë më 12 shkurt 2007 dhe se, sipas pohimit personal, aktgjykimin e ka pranuar më 10 prill 2007.
24. Gjithmonë duke marrë parasysh afatet kohore, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktit të Autoritetit publik (Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë i datës 12 shkurt 2007 i pranuar nga pala më 10 prill 2007), që daton nga një periudhë kohore para se Kushtetuta e Republikës së Kosovës të hynte në fuqi (15 qershor 2008), prandaj Gjykata Kushtetuese nuk mund të vlerësojë kushtetutshmërinë e akteve juridike me anë të së cilave supozohet shkelja e ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë sepse në atë kohë ato as janë përcaktuar e as garantuar me Kushtetutë nga shkakun se vetë Kushtetuta nuk ka ekzistuar, prandaj konstatohet se kërkesa është *ratione temporis* e papranueshme në raport me Kushtetutën (shih Blečić v. Kroaci, kërkesa nr. 59532/00, Aktgjykimi i GJEDNJ-se, 29 korrik 2004 ku GJEDNJ kishte shpallë të papranueshme atë kërkesë sepse dispozitat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk obligojnë palët kontraktuese lidhur me asnjë akt që është nxjerrë, apo situatë juridike, që ka përfunduar së ekzistuar para se konventa të hyjë në fuqi.
25. Një arsyetim të tillë Gjykata Evropiane e kishte përdorë edhe kur ka shpallur të papranueshme Jasiiniene kundër Lituaniës (shih *mutatis mutandis* Jasiiniene kundër Lituaniës, kërkesa nr. 41510/98, Aktgjykimet e GjEDNJ-se, të 6 marsit dhe 6 qershorit 2003).
26. Edhe sikur kërkesa të kishte të bëjë me një çështje që daton pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, ajo prapë se prapë nuk do të plotësonte kriteret e pranueshmërisë të parapara me nenin 113.7 të Kushtetutës, pasi që parashtruesi i saj nuk kishte shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion para se ti drejtohej Gjykatës Kushtetuese, sepse si provë materiale në kërkesën e tij kishte ofruar vetëm aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë CI.nr.307/2006, të datës 12 shkurt 2007, dhe nuk kishte ofruar prova për përdorimin e mjeteve tjera juridike të ankimit.
27. Në këto rrethana, parashtruesi i kërkesës nuk ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë dhe:


PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36.3(h) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e 15 majit 2011, njëzëri

VENDOS


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme sepse ajo nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën.
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20-4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues



Mr. sc. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani